

UDHËZIM
Nr. 17, datë 27.11.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1468, DATË 26.6.2006 "PËR
ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 223, DATË 19.4.2006
"PËR PAGESËN E TË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006 "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia", ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 1468, datë 26.6.2006 "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006 "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia" bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Pika 13 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

"E ardhura nga papunësia është mujore dhe paguhet përpjesëtimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë të marrë këtë të ardhur. Pagesa jepet një herë në muaj pranë bankës, pasi personi përfitues të jetë paraqitur në zyrën e punësimit. Ajo i jepet vetëm personit përfitues, përkundrejt paraqitjes në bankë të dokumentit të identifikimit ose kartës së debitit."

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erion Veliaj